



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 105, datë 25.03.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËS SË SKEMËS SË DELEGIMIT**  
**ZNJ. {...}, NË GJYKATËN E APELIT KORÇË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës aktuale dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Korçë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 25.03.2022.
2. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. Sonjela Voskopi përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.05.2021.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së skemës së delegimit, znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Apelit Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**